

(“Gazeta zyrtare e RM ”, nr. 63/2000- teksti bazë) Ndryshimet: (“Gazeta zyrtare e RM ”, nr.29/2002, 43/2002, 49/2003, 81/2008, 158/2010, 43/2014, 15/2015, 27/2016 dhe 83/2018)

## LIGJI PËR FONDIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

### 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### **Neni 1**

Me këtë ligj përcaktohet dhe rregullohet puna dhe organizimi i Fondit për Sigurimin e Depozitave.

#### **Neni 2**

Fondi për Sigurimin e Depozitave (në tekstin në vijim: Fondin) e themelon dhe është në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Fodi është pasardhës ligjor i Fondit për Sigurimin e Kursimeve Depozitare.

#### **Neni 3**

Fondi ka status të personit juridik. Selia e Fondit është në Shkup.

#### **Neni 3-a**

Fondi është institucion i specializuar financiar i cili bënë dëmshpërblimin e depozitave të siguruara në banka, filijalet e bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit, në të cilin ka ndodh rast rreziku, në bazë të nenit 9 pika 1 e këtij ligji.

### 2. DEPOZITAT TË CILAT JANË SUBJEKT DËMSPËRBLIMI

#### **Neni 4**

Bankat, filijalet e bankave të huaja dhe shtëptë e kursimeve të themeluara në Republikën e Maqedonisë janë të obliguara që depozitat ti sigurojnë në Fond. Në bazë të këtij ligji depozita llogariten ato në denar dhe devizë, qertifikata për depozita, llogaritë transakcionale, depozitat e lidhura me kartelat e parave dhe të hyrat devizore të personave fizik (në tekstin në vijim: depozita).

Në rast dëmshpërblimi nga ana e Fondit, depozitat individuale të një personi në bankë llogariten si një depozit i vetëm.

## **Neni 4-a**

Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë do të sjell vendim për ndalimin e grumbullimit të depozitave në bankë, filijalë të bankës së huaj ose shtëpisë së kursimit, për atë subjekt i cili është përjashtuar nga antarësimi në Fond për arsye të mos pagimit të premisë. Anëtarësimi në Fond mbaron dhe në rast se guvernatori i Bankës Popullore sjell vendim për ndërprerjen e lejes së punës së bankës, filijalës së bankës së huaj ose shtëpisë së kursimit. Fondi i siguron depozitat e përgjithshme të bankave, të bankave të huaja ose shtëpive të kursimit të deponuara deri në ditën e sjelljes së vendimit përfundimtar nga pikat **1 dhe 2** të këti neni.

## **3. MJETE**

### **Neni 5**

Mjetet financiare të Fondit përbëjnë më së paku 4% të depozitave të përgjithshme në banka, filijalet e bankave të huaja ose shtëpive të kursimit në Republikën e Maqedonisë. Me mjete financiare të Fondit nënkuptojmë mjetet të cilat gjenden në llogarinë e Fondit dhe Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, llogaritë e Fondit në bankat afariste dhe mjetet financiare të investuara në letra me vlerë. Kur mjetet e Fondit do ta kalojnë nivelin nga pika 1 e këti neni, Bordi drejtues i Fondit mund të sjell vendim për ndërprerje të obligimit për pagimin e premive në Fond nga ana e bankave, filijaleve të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit. Me përjashtim të paragrafit 4 të këti neni, bankat, filijalet e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimit paguajnë premi në periudhën kur jemi nën marrjen e masave shtesë nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në përputhje me nenin 133 të Ligjit për banka ose vënien e pëlqimit administrativ në pajtim me nenin 139 të Ligji për banka.

Premia paguhet në bazë të tarifës (shkallës) së caktuar nga ana e Bordit drejtues të Fondit.

### **Neni 6**

Mjetet e Fondit formohen nga investimi bazë (themelor), pagesa e premive për sigurimin e depozitave dhe të ardhurave nga plasmani. Mjetet me të cilat disponon Fondi mund ti plasoj në:

1) letra me vlerë të dhëna nga Republika e Maqedonisë dhe nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë me afat prej dymëdhjetë muaj që nga ana e posedimit të Fondit dhe

2) letra me vlerë borxh të dhëna nga shtete të huaja, banka qendrore ose nga insitucione financiare ndërkombtare publike, të ranguara më së paku nga dy agjensione të pranuar ndërkombtarisht për vlersimin e rrezikut kreditor në një rën nga dy kategoritë më të larta, në vlerën më të lartë të depozitit të siguruar që janë në valutë të huaj. Mjetet e Fondit mund të përdoren vetëm për dëmshpërblimin e depozitave të siguruar dhe për mbulimin e shpezimeve të punës së Fondit.

### **Neni 7**

Për sigurimin e depozitave Fondit i paguhet premi nga anëtarët e Fondit me vlerë (shkallë) më së shumti deri në 0,7% në vit nga vlera e përgjithshme e depozitave në çdo bankë, filjalë e bankës së huaj dhe shtëpisë së kursimit. Mënyrën, afatin e pagimit dhe shumën e premisë nga paragrafi 1 i këti neni e cakton Bordi drejtues i Fondit.

Në rast të vonesës së pagimit të premisë nga paragrafi 1 i këti neni, Fondi përllëgarit dhe vendos pagesë me kamatvonesë ligjore. Në rast të mos pagesës së premisë nga paragrafi 1 i këti neni në periudhë prej gjashtë muajsh njëri pas tjetrit, ndërpritet antarsimi në Fond. Fondi është i obliguar menjëherë ta informoj Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë për rastet nga paragrafi 3 dhe 4 i këti neni. Mjetet e paguara në bazë të premive në Fond nga ana e bankave, filijaleve të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimeve janë të pakëthyeshme. Themelimi i ri i bankave, filialeve të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit gjatë antarsimit në Fond, duhet të paguajnë premi në vlerë prej 1% nga kapitali bazë.

### **Neni 8**

Nëse Fondit i mungojnë para për dëmshpërblimin e depozitave të siguruar, Fondi siguron mjete shtesë nëpërmjet: 1) pagesave shtesë nga bankat, filialet e bankave të huaja dhe shtëpive të kursimeve, por jo më shumë se trefishi i vlerës së premive të paguara në muajin i cili përkon me muajin në të cilin guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ka sjell vendimin nga neni 4-a paragrafi 2 i këti ligji; 2) marrje hua në vend dhe jashtë; 3) hua nga

Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Pagesa shtesë nga paragrafi 1 pika 1 e këtij neni bankat, filialet e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimeve janë të obliguara që të paguajn mjetet në llogarin e Fondit më së voni tetë ditë nga dita e dorëzimit të përlllogaritjes nga ana e Fondit deri tek bankat, filialet e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimit.

#### **Neni 8-a**

Nëse Fondit i mungojn mjete likuiditeti për dëmshpërblimin e depozitave të siguruara të personave fizik, Ministria e Financave mund ti blej letrat me vlerë të lëshuara (dhëna) nga Republika e Maqedonisë cilat janë në pronësi të Fondit, para afatit të përfundimit. Blerja do të kryhet pa shpallje të thirrjes publike.

### **4. DËMSHPËRBLIMI I DEPOZITAVE**

#### **Neni 9**

Fondi fillon me dëmshpërblimin e depozitave të siguruara në afat prej 20 ditësh nga dita e sjelljes së vendimit përfundimtar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë nga neni 4-a paragrafi 2 i këtij ligji. Në rrehana të jashtëzakonshme, Fondi mund ta vazhdoj afatin nga paragrafi 1 i këtij neni më së shumti deri në dhjetë ditë. Fondi bënë dëmshpërblimin e depozitave të siguruara, por jo më shumë se 30.000euro në kundërvlerë me denarin për depozitor të një banke, filiale të bankës së huaj ose shtëpije kursimi të llogaritura sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën përfundimtare të sjelljes së vendimit nga neni 4-a paragrafi 2 i këtij ligji. Në vlerën nga paragrafi 3 i këtij neni përlllogaritet depoziti kryesor, interesi i akumuluar dhe ai i parrituri i përlllogaritur deri në sjelljen e vendimit përfundimtar për të cilin kanë rënë dakord, nga neni 4-a paragrafi 2 i këtij ligji. Në ditën e sjelljes së vendimit përfundimtar nga neni 4-a paragrafi 2 i këtij ligji depozita e deponuara në devizë shëndrohen në denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Dëmshpërblimi i depozitave në denar dhe atyë devizore paguhen në denar. Në rast dyshimi se kërkesat e deponentëve të anëtareve të Fondit rrejdhin nga transaksione të lidhura me pastrim parash ose financim të terrorizmit, dëmshpërblimi i kërkesave të deponentëve nuk do të kryhet deri në vendimin përfundimtar të gjyqit për lidhshmërinë transaksionale me pastrimin e parave ose financimit të terrorizmit.

## 5. DEPOZITA TË CILAT NUK KOMPENZOHEN

### **Neni 10**

Fondi nuk bënë komenzimin e depozitave si vijojn: 1. Depozita të cilave u është dhënë kushte të kamatave të privileguara, të ndryshme nga ata të cilat janë të publikuara nga ana e bankës, filialave të bankave së huaja ose shtëpive të kursimit; 2. Depozita të deponentëve pronar të mbi 5% të akcioneve me të drejtë menaxhimi me bankën, filialën e bankës së huaj ose shtëpisë së kursimit; 3. Depozita të anëtarëve të organeve të bordit drejtues të bankës, filialës së bankës së huaj dhe shtëpisë së kursimit; 4. Depozita të familjarëve të rrethit të parë të depozitave nga pika 2 dhe 3 të këti neni; 5. Depozita të lidhura me llogari transakcionale me të cilat është kryer larje prash në rastëse shkelsi është dënuar dhe i njejtë është në fuqi. Në rast kur deponenti ka obligime ndaj bankës, filialit të bankës së huaj ose shtëpisë së kursimeve vlera e përgjithëshme e depozitit të deponentit zvogëlohet në pajtim me obligimet që ka ndaj bankës, filialit të bankës së huaj ose shtëpisë së kursimit. Në rast të depozitave të përbashkëta llogaritet se mjetet e depozituara janë të barabarta nëse në marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe. Gjat komfirmimit të vlerës nga neni 9 paragrafi 3 i këti ligji merret parasysh pjesëmarrja e cdo deponenti në llogarin ë e përbashkët.

## 6. ORGANET E FONDIT

### **Neni 11**

Organet e fondit janë: Bordi drejtues dhe drejtori

### **Neni 12**

Bordi drejtues është i përbërë nga pesë anëtar të emruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe atë tre me propozim të ministrit të financave, një me propozim të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe një me propozim të Shoqërisë për Banka dhe Sigurim i cili duhet të jetë nga radhët e ekspertëve në lëminë e bankare dhe financiare i cili nuk duhet të jetë anëtar i organit drejtues ose i punësuar në bankë, filial të bankës së huaj ose shtëpie kursimi. Bordi drejtues sjell akte nënligjore me anë të së cilave rregullohet puna e Fondit. Anëtarët e Bordit drejtues emrohen me mandat prej katër viteve. Për punën e vetë Bordi drejtues përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë .

### **Neni 13**

Drejtorin e Fondit e emron Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mandat prej katër viteve. Për emrimin e drejtorit shpallet konkurs publik në më së paku tri gazeta ditore të cilat shpërndahen në tërë teritorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që publikohet në gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Për drejtor mund të emrohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emrimit të mos i jet shqipëtuar dënim me vendim të plotë fuqishëm gjyqësor ose sanksion kundravajtës për ndalim të kryerjes së profesionit, obligimeve ose aktivitetit ;
- 3) të posedoj 240 kredi sipas EKTS ose shkallën VII/1 ;
- 4) të ketë më së paku pesë vite përvojë pune;
- 5) të mos jet anëtar i organit drejtues ose i punësuar në bankë ose shtëpi kursimi;
- 6) të posedoj njërën nga certifikatat e pranuar ndërkombtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më e vjetër se pesë vjet:

TOEFEL IBT më së paku 74 pikë,

- IELTS- më së paku 6 pikë, ILEC

( Cambrige English Legal)- më së paku niveli B2 ,

FCE (Cambrige English Fisrt))- të dhënë ,

BULATS- më së paku 60 pikë ose APTIS – më së paku niveli B2

### **Neni 14**

Anëtarët e Bordit drejtues dhe drejtori i Fondit shkarkohen para përfundimit të mandatit për të cilin janë të emruar, nëse janë të dënuar për vepër penale kundër pronësisë ose për kundravajtje në punën e lëmisë financiare si dhe për mënyrën dhe procedurën e emrimit të tyre.

## **Neni 15**

Puna dhe organizimi I Fondit rregullohen me statutin e Fondit. Statutin e sjell Bordi drejtues. Qeveria e Republikës së Maqedonisë jep pëlqim për statutin e Fondit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë e vërteton planin financiar dhe llogarinë vjetore të Fondit.

### **Neni 15-a**

Të punësuarit në Fond të cilët kryejn punë administrative kanë status të nëpunësve administrative. Për çështje të cilat kanë të bëjnë me mardhëniet e punës të të punësuarëve nga paragrafi 1 i këti neni të cilët nuk janë të rregulluar me këtë ligj dhe marrveshjen kolektive, aplikohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativ dhe dispozitat e përgjithëshme për mardhënie pune. Të punësuarit në Fond të cilët kryejn punë ndihmëse -teknike kanë statusin e e personelit ndihmës-teknik. Personelit ndihmës-teknik të Fondit do ti aplikohen dispozitat e përgjithshme për mardhënie pune.

### **Neni 15-b**

Mënyra e përcaktimit të rrogës bazë dhe shtesave të saj për të punësuarit në Fond rregullohet me marrëveshje kolektive, ndërsa vlerën e pikëve të rrogës bazë e përcakëton Bordi drejtues i Fondit me propozim të drejtorit.

## **7. RAPORTET**

### **Neni 16**

Fondi për punën e vetë përgatit raporte gjysëm vjetore dhe vjetore. Fondi është i obliguar që ta publikoj raportin vjetor për punën e vetë në më së paku një nga mjetet e informimit publik. Revizor i autorizuar kryen revizion në punën e Fondit. Raporti nga revizioni i kryer publikohet në më së paku në një mjet informimi publik. Fondi është i obliguar që deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë ta dorëzoj raportin vjetor të punës , së bashku me raportin e revizionit të kryer

## 8. INFORMIMI

### Neni 17

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është e obliguar, që me kërkesë të Fondit të dorëzojnë raporte periodike financiare në lidhje me të gjitha informacionet relevante për gjendjen e antareve të Fondit. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni bazohen në raportet e supervizionit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të dorëzojë deri te Fondi raporte mujore për depozitat e përgjithshme nëpër banka, filiale të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit, të cilat përbajnë të dhëna për depozitat bazë dhe kamatat e depozitave nga neni 4 pika 2 e këtij ligji. Raportet mujore dorëzohen deri në Fond më së voni deri më ditën e 25-të të muajit vijues, për muajin e kaluar. Me kërkesë të Fondit, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është e obliguar që të dorëzojë raport për bankat, filiale të bankave të huaja dhe shtëpive të kursimit anëtare të Fondit të cilat janë nën masat e ndërmarra shpesh nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 133 të Ligjit për banka ose që është vënë pajtueshmëri administrative në pajtim me nenin 139 të Ligjit për banka. Raporti dorëzohet më së voni dhjetë ditë nga pranimi i kërkesës. Me kërkesë të Fondit, administratorët e emruar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë janë të obliguar që të dorëzojnë Fondit raport për gjendjen financiare dhe perspektivat e bankës, filialit të bankës së huaj dhe shtëpisë së kursimit. Raporti dorëzohet më së voni dhjetë ditë nga pranimi i kërkesës së dorëzuar nga ana e Fondit. Bankat, filialet e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimeve të cilat janë anëtare të Fondit janë të obliguara që të dorëzojnë Fondit raport tre mujor për gjendjen e numrit të përgjithshëm të deponentëve në vlerë deri më 30.000 euro dhe për deponent me depozita mbi 30.000 euro. Raporti dorëzohet më së voni deri në ditën e 15-të të muajit për tremujorin e kaluar. Të dhënat të cilat dorëzohen në Fond përmbajnë të dhëna të klasifikuara.

### 8-a DISPOZITA KUNDRAVAJTËSE

#### Neni 17-a

Për shkeljet e përcaktuara me këtë ligj, personat e autorizuar të Fondit për Sigurimin e Depozitave, në suaza të autorizimeve të veta, kryesit të veprës



penale i ofrojn pëlqim për marrëveshje të arritur me çka kryersi i veprës duhet ta paguaj gjobën, të dhënat e tjera ose që ti largoj pasojat e shkeljes.

Procedura për marrëveshje ngrihet me dorëzimin e ofertës nga ana e personit të autorizuar nga Fondi për Sigurimin e Depozitave deri tek kryersi i veprës penale në afat prej tetë ditësh nga dita e konstatimit të kryerjesh së veprës penale. Kryersi i veprës penale është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të ofertës nga paragrafi 2 i këti neni të jap pëlqim me shkrim për ngritjen e procedurës për marrëveshje. Personat e autorizuar nga Fondi për Sigurimin e Depozitave për rastet nga paragrafi 3 i këti neni përgatisin procesverbal në të cilën konstatohet pajtueshmëria e të dya palëve për ngritjen e procedurës për marrëveshje në të cilin nënshkruhet edhe kryersi i veprës penale. Drejtori i Fondit për Sigurimin e Depozitave me akte nënligjore e përcakton numrin, nivelin e nevojshëm të profesionit dhe përvojën e punës të antarëve të Komisionit për marrëveshje. Komisioni për marrëveshje punon me mbledhje(seanca) në të cilën në mënyrë të obligueshme marrin pjesë përfaqësuesit e kryersit të veprës penale. Pas marrëveshjes së përfunduar për me çka është arritur pëlqim dypalësh përgatitet marrëveshje. Në marrëveshje përcaktohen obligimet e kryersit të veprës penale, veçanërisht:

- 1) vlera(shuma) dhe mënyra e pagimit të gjobës;
- 2) vlera(shuma) dhe mënyra e pagimit të shpenzimeve të tjera shtesë dhe
- 3) masat të cilat duhet ti ndër marr kryersi i veprës penale me qëllim të largimit të pasojave nga shkelja penale.

Marrëveshja nga paragrafi 7 i këti neni ka fuqinë e dokumentit ekzekutiv. Drejtori i Fondit për Sigurimin e Depozitave sjell rregullore dhe listën e kostove(shpenzimeve) për punën e Komisionit për marrëveshje. Lloji i kostove dhe shuma e vërtetuar sipas listës për shpenzime përcaktohen sipas shpenzimeve reale të cilat Fondi për Sigurimin e Depozitave i ka komfirmuar për të punuar Komisioni për marrëveshje. Komisioni për marrëveshje është i obliguar të mbaj evidencë për procedurat e filluara për marrëveshje dhe për përfundimin e tyre.

### **Neni 17-b**

Gjobë në vlerë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundër vlerë me denarin do ti shqipëtohet personit zyrtar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për shkelje nëse nuk i dorëzon ose i vonon(nuk i lëshon në kohë) raportet nga neni 17 paragrafi 1,3 dhe 4 i këti ligji.

### **Neni 17-v**

Gjobë në vlerë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarin do të shqipëtohet për shkelje bankës, filialit të bankës së huaj ose shtëpisë së kursimeve anëtare të Fondit, të cilat nuk do të dorëzojnë në kohë raportet nga neni 17 paragrafi 6 i këtij ligji në Fond ; në afatin e caktuar të paguaj periminë shtesë nga neni 8 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji.

### **Neni 17-g**

Gjobë në vlerë prej 30% nga gjoba e vlerësuar për bankën do të ju shqipëtohet për shkelje të nenit 17-v të këtij ligji personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të bankës.

### **Neni 17-d**

Për shkelje sipas nenit 17 paragrafit 5 të këtij ligji , për mos dorëzim ose dorëzim me vonesë të raportit do të ju shqipëtohet gjobë në vlerë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarin administratorëve të bankës, filialës së bankës së huaj dhe shtëpive të kursimeve.

### **Neni 17-gj**

Matja e vlerës së gjobës për persona juridik kryhet në pajtim me Ligjin për kundravajtje.

## **9. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 18**

Fondi do të fillojë me punë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni Republika e Maqedonisë do të blejë akcionet e bankave dhe shtëpive të kursimit të cilat janë themeluese të Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kursimeve, do të jua paguaj akcionet në Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kursimeve sipas vlerës së tyre normale. Mjetet e blerjes së akcioneve nga paragrafi 2 i këtij neni do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 19**

Nga dita e fillimit me punë të Fondit nuk do të vlejn pjesa III-a – Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kurësya dhe dispozitat 93-a deri te 93-l të Ligjit për banka dhe shtëpive të kursimit

(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr. 31/93; 78/93; 17?96; 37?98 dhe 25/2000), ndërsa Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kusyera do të fshihet nga regjistri tregëtar.

## **Neni 20**

Në momentin e anëtarimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropjan do të mbarojn së ekzistuari (nuk do të vlej) dispozitat nga neni 6 paragrafi 3 i këti ligji të cilët do të zavendësohen dispozitat e nenit 9 paragrafi 3 i Ligjit për Fondin e Sigurimit të Depozitave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 63/2000, 29/2002, 43/2002, 49/2003 dhe 81/2008), si dhe dispozitat e nenit 8 paragrafi 4 i këti ligji me çka do të ndryshohen dispozitat e nenit 17 paragrafi 6 i Ligjit për Fondin e Sigurimit të Depozitave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ,, nr. 63/2000, 29/2002, 43/2002, 49/2003 dhe 81/2008).

## **Neni 21**

Prej ditës së anëtarimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropjan për depozita në lidhje me këtë ligj do të nënkuptohen depozitat në denar dhe devizë, llogarit transakcionale, depozita të lidhura me kartela parash dhe të hyrat devizore të personave juridik të cilët sipas Ligjit për shoqëri tregëtare ( „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr. 28/2004, 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10 dhe 48/10) llogariten si tregëtar të vogël.

## **Neni 22**

Prej ditës së anëtarimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropjan, Fondi do ti kompenzoj depozitat e siguruara, në vlerë jo mbi 100.000 euro për depozitë në një bankë, filialë të bankës së huaj ose shtëpi kursimi të përlllogaritura sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë deri në ditën e sjelljes së vendimit përfundimtar nga neni 4-a paragrafi 2 i këti ligji.

### **Neni 23**

Prej ditës së anëtarimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropjan, bankat, filialet e bankave të huaja dhe shtëpit e kursimeve anëtare të Fondit janë të obliguara që ti dorëzojn Fondit raport tremujor për gjendjen e përgjithshme të depozitave me vlerë deri ne 100.00 euro dhe mbi 100.000 euro. Raporti dorëzohet më së voni deri në ditën e 15-të të muajit për tremujorin e kaluar.

### **Neni 24**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë,,.